



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing		
02	No.Nr.	151/20
Tarih/Dt.		24.07.2020



Referenca : 626/20/016/121

Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik neni 4 pika b dhe nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 bie këtë :

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik –NTSH “NAZI TRAVEL” - PRISHTINË e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 22.07.2020 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-20-2480-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-20-016-1-2-1 me titull “FURNIZIMI ME DRU DHE PELET PËR NGROHJE”

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik NTSH “NAZI TRAVEL”,Rr. Jakup Ferri, Nr.5. PRISHTINË më datën 22.07.2020 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, në të cilin njoftim është përcaktuar përfituesi i tenderit për “FURNIZIMI ME DRU DHE PELET PËR NGROHJE” për Komunën e Mamushës.

Si autoritet kontraktues, pas pranimi të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar e kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të rregullores për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim, pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave. O.E NTSH "NAZI TRAVEL" Rr.Jakup Ferri, Nr.5. PRISHTINË, ka paraqitur pretendime të pa bazuara si më poshtë.

O.E në pretendimin e parë ka cekur se kinse në si Autoritet Kontraktues kemi bërë shkelje të dispozitave të LPP konkretisht të nenit 7 i cili ka të bëjë me transparencën dhe trajtimit të barabartë të Operatorëve Ekonomike dhe palëve tjera në procedurë.

Në kemi respektuar në tërësi dispozitën e lartcekur të LPP-s pasi që vlerësimi është bërë në mënyrë të drejtë dhe të pa anshme dhe kemi trajtuar njëjtë në mënyrë të barabartë të gjithë tenderuesit.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional në pikën nr. 1 është paraqitur kërkesa si vijon: **1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimumi tre kontrata gjatë tri viteve të fundit.**

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

1. Lista e projekteve të realizuara për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës(transaksioni bankar fatura etj).

Pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues se kërkesa është ndryshe nga dëshmia është i pa qëndrueshëm, pasi që kërkesat paraqesin aftësitë të cilat duhet t'i ketë një operator ekonomik për tu konsideruar i përgjegjshëm për realizimin e një kontrate, ndërsa dëshmitë paraqesin dokumentet për të dëshmuar se një O.E. i caktuar i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktues. Në dosje të tenderit në anën e majtë janë paraqitur kërkesat minimale për tu konsideruar një tender i përgjegjshëm, ndërsa në anën e djathtë janë paraqitur dëshmitë (dokumentet me të cilat duhet të dëshmohet se O.E. i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktues të paraqitura në anën e majtë).

Operatori Ekonomik ankues, NTSH "NAZI TRAVEL" në tenderin e tij ka dorëzuar listën e projekteve por nuk ka dorëzuar kopjet e referencave apo raportet për realizimin me sukses të kontratave të paraqitura në listë.

Duke u bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-s me qëllim të vlerësimit të drejtë të tenderit të O.E. ankues, në datën 10.07.2020 kemi kërkuar që të na jep sqarime në lidhje me dëshminë e lartcekur, si dhe ia kemi dhënë mundësinë që në rast se i posedon referencat e paraqitura në listën e projekteve të realizuar të njëjtat të na sjellë tek ne brenda afatit prej 6 (Gjashtë) ditëve nga data

e dorëzimit të kërkesës për sqarimin e tenderit. Gjithashtu me datën e njëjtë me qenë se nuk ka paraqitur dokumentin CRA ose DUD edhe për ngarkuesin, kemi kërkuar që të na jep sqarim sipas kërkesës në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

O.E. ankues me datën 13.07.2020 në ora 10:57 ka dërguar përgjigjen e tij dhe si dëshmi ka paraqitur DUD-in për ngarkues si dhe ka paraqitur vetëm një referencë për kontratat e realizuara të paraqitura në listën e projekteve. Andaj me qenë se në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë është kërkuar që O.E. pjesëmarrës duhet ti ketë realizuar minimumi tri kontrata dhe si dëshmi ti sjellë referencat ose raportin për realizim të kontratës ne duke u bazuar në nenin 59 të LPP-s e kemi refuzuar tenderin e tij si të pa përgjegjshëm.

Ndërsa në pretendimin e dytë O.E ka cekur se AK ka bërë shkelje të LPP-s konkretisht të nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderit, ku ne si AK konsiderojmë që është e pabazuar pasi që gjatë vlerësimit kemi aplikuar dispozitat e nenit 59 të LPP-s dhe dispozitat nenit 41 paragrafi 41.1, 41.2 dhe 41.3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Sa i përket pikës nr. 2 të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkuara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në të cilat është kërkuar që:

2. OE duhet te ofroj dëshmi se posedon makinerinë dhe mjetet e punës, te domosdoshme për furnizim me dru dhe pelet, së paku 3(tre) kamionë min. 7 ton, si dhe së paku një ngarkues.

Si dëshmi është kërkuar:

2. Lista e makinerisë dhe mjeteve te punës qe do te përdoret ne realizim te projektit, origjinale e nënshkruar dhe vulosur nga O.E, e dëshmuar me dokumentacion te pronësisë (Duhet të kopjohen Certifikatat e Regjistrimit të automjetit (CRA) të mjeteve ose dokumenti unik doganor (DUD) dhe të paraqiten me rastin e tenderimit) ose nëse merren në shfrytëzim (kontrata origjinale për shfrytëzim si dhe dëshmitë e pronësisë së dhënësit në shfrytëzim të cekura më lartë)

Njëjtë sikur në kërkesën nr. 1 në anën e majtë janë paraqitur kërkesat ndërsa në anën e djathtë janë paraqitur dëshmitë, por në këtë rast O.E. ankues ka dorëzuar si dëshmi kopjet e Certifikatave të Regjistrimit të automjetit (CRA) të mjeteve, marrëveshjet me O.E. tjerë për shfrytëzimin e mjeteve si dhe DUD-in, për tre kamionë dhe një ngarkues, mirëpo kamioni i markës Daimler Chrysler tipi Atego 823K nuk i ka plotësuar kërkesat pasi që ka qenë me peshë 4815 kg.

Ne si autoritet kontraktues kemi zbatuar legjislacionin e Prokurimit Publik në Kosovë që nga shpallja, hapja, vlerësimi e deri te vendimi për dhënie të kontratës. Dispozitat e nenit 59 të LPP-s dhe dispozitat e nenit 41 paragrafët 41.1, 41.2 dhe 41.3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, shprehimisht kanë paraparë që tenderët duhet të jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar) për të qenë të përgjegjshëm.

Pasi që O.E. ankues nuk i ka përmbushur kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë për arsyet e cekura më lartë, konsiderojmë se me të drejtë, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se O.E. ankues ka dorëzuar tender të pa përgjegjshëm, andaj edhe i është refuzuar oferta.

Pra duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe dëshmitë dhe faktet e paraqitura nga O.E. konsiderojmë se pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga O.E. asesi nuk janë të bazuara sepse sa i përket pretendimeve që kinse kemi shkelur ligjin dhe udhëzuesin, absolutisht provat tregojnë se Autoriteti Kontraktues ka respektuar në përpikëri të gjithë procedurën e prokurimit e që aspak nuk mendojmë që kemi bërë shkelje në Ligjin dhe RrUPP-n në analizimin dhe vlerësimin e çështjeve të cilat i ka theksuar Operatori Ekonomik ankues.

Andaj


Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, 24.07.2020

Gazmend Gashi

Udhëheqësi i sektorit të prokurimit

Komuna Mamushë



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjet (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.